



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 48, datë 26.03.2021

**PËR
MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT PËR PËRLLOGARITJEN E
PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK PËR DËMET QE U
SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI, TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 10, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe pikës 22, të nenit 14, të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat TPL të sigurimit, tabela 1 bashkëlidhur këtij vendimi.**
- 2. Shoqëria publikon primet e rrezikut si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Tabela e primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete për kontratat TPL të sigurimit:

Tabela 1

KAT	KLASA	TIPI	Kapaciteti Motorik (cm ³)ose pesha bartëse (T) ose numri i vendeve	Tarifat e primit të rrezikut të përlllogaritura (në lekë)
A 1		Motorçikleta	Kapaciteti Motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	2,600
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	4,200
B 1		Autovetura	Kapaciteti Motorik	
	B 1/1		Deri në 1600 cm ³	6,300
	B 1/2		Mbi 1600 cm ³	9,000
B 2		Furgona, Mikrobuse	Nr. Vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	12,400
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	17,000
C 1		Autobuse	Nr. Vendeve	
	C 1/1		Mbi 15 vende	28,000
D 1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 1/1		Deri në 3.5 ton	11,800
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 2/1		Mbi 3.5 ton	19,700
E 1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (Ton)	5,800
F		Mjete bujqësore		4,500
G		Zjarrfikëse		10,200